



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1525/prot.

Tiranë, më 21.10. 2020

VENDIM

Nr. 29, datë 21.10. 2020

“Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të UT-së, për vitin akademik 2020-2021”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma f; si dhe në propozimet e përcjella nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me shkresat nr. 453/5 Prot., datë 16.04.2020; nr. 453/7 prot., datë 26.05.2020 dhe 453/11 prot., datë 09.09.2020, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 21.10.2020;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për ndryshime deri në masën 20% në planet mësimore të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2020-2021, në:
 - “Bachelor” në “Bioteknologji”;
 - “Bachelor” në “Kimi”;
 - “Bachelor” në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”;
 - “Bachelor” në “Kimi Industriale dhe Mjedisore”;
 - “Bachelor” në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”;
 - “Master i Shkencave” në “Kimi”;
 - “Master i Shkencave” në “Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore”;
 - “Master i Shkencave” në “Matematikë”;
 - “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”;
 - “Master Profesional” në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”;
2. Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha